

«Kur

hiqen

maskat»

Femi Hoshati



Aktorët Skënder Sallaku (Artist i Popullit) dhe Skënder Plasari në filmin «Kur hiqen maskat».

Shenjë e sigurtë e zhvillimit të një shoqërie të re, është ndër të tjera edhe prirja e saj ndaj humorit, tendenca për të fshikulluar çdo gjë që pengon ecjen e saj përpara, vënien në lojë të gjithçkaje të dalur boje, të vjetëruar dhe që është qesharake në vetë thelbin e saj. Filmi kinospetaktel «Kur hiqen maskat» i regjisorit Dhimitër Anagnosti, nëpërmjet skeçeve, mbi bazën e të cilëve është ndërtuar, na jep një ide të luftës që bën shoqëria jonë, në aspekte të ndryshme të zhvillimit të saj. Në film shohim se si njëri tip zëvendëson tjetrin... Në një skeç shohim se ata që guxuan të shkelin vendin, apo ata që iu kundërvunë interesave të popullit, morën atë që u takonte, një mësim ky i hidhur për ujqit imperialistë e revizionistë, që nuk heqin dorë nga qëllimet e tyre po dhe që kurdoherë i pret disfata e plotë. Në një skeç tjetër shohim se sa qesharake është që të kërkosh në Shqipërinë e ditëve tona qoftë edhe një malarik të vetëm. Aty shohim njeriun e punës, me psikologjinë e re socialiste, që punon për ndërtimin e jetës së re. Por mund të gjesh edhe të atillë që ruajnë akoma në ndërgjegjen e tyre mbeturina të një psikologjie të huaj për shoqërinë tonë. Saliu, p.sh., është prototip i asaj kategorie njerëzish që bëhen qesharake, pikërisht sepse veprojnë në kundërshtim me normat e moralit komunist. Të huaja janë qëndrimet e Robertinos dhe pozat e tij, prandaj janë edhe qesharake. Të tillë dalin ata prindër që edukimin e fëmijëve të tyre e kuptojnë së prapthi, apo ata njerëz që thyejnë disiplinën në punë.

Qëllon që të takojmë në jetën tonë njerëz që vënë maska. Ata janë njerëzit e paformuar ideologjikisht, që ruajnë në vetvete «bagazhin» e trashëguar nga e kaluara, prandaj edhe veprimet dhe qëndrimet e tyre bien ndesh me idealat dhe moralin e ri socialist. Është detyrë e çdo qytetari të shoqërisë sonë që të mos qëndrojë indiferent dhe t'ua heqë maskat bartësve të këtyre të këqijave.

Materiali i pasur tematik shtrohet dhe zgjidhet drejt në film. Konflikti dramatik ruan, përgjithësisht, sensin e masës. Filmi, nga fillimi deri në fund ka ndje-

njen e humorit, jo të një humorit për humor, jo të së qeshurës për të qeshur, të batutës banale apo të gjestikulacionit dhe efekteve të jashtme. Materiali, përgjithësisht, është zgjedhur drejt dhe ruan përpjestimet e duhura në problematikë.

Duke patur një koncept regjisorial të caktuar, është bërë e mundur që materialet me karakter të ndryshëm të njësohen, të lidhen në një linjë të vetme, gjë për të cilën ka ndihmuar, sigurisht, gjetja e asaj nyjeje, që është kalimi i aktorit kryesor nga njëri tip tek tjetri.

Përmbajtja e shëndoshë e skeçeve, humori që ata i komunicojnë spektatorit nëpërmjet lojës së aktorëve dhe sidomos Artistit të Popullit Skënder Sallaku, plotësohet nga ai sfond i pasur e gazmor që të zgjon muzikën e filmit. Përmbajtja optimiste e këngëve ndihmon së tepërmi në krijimin e një gjendjeje të mirë humorit tek spektatori. Gjuha filmike, me të gjithë gamën e mjetëve shprehëse kinematografike, është vënë në shërbim të zgjidhjes së idesë së filmit që qëndron në demaskimin e koncepteve të huaja, të cilat shfaqen në forma e mënyra të ndryshme tek njerëzit tanë.

Gjetje të tilla regjisoriale, si heqja dhe vënja e maskave, të fut përnjëherësh në atmosferën e caktuar, të zgjon mendimin që filmi do të zbërthejë pikërisht këtë mendim. Po kështu dublimi i personazhit, flet, gjithashtu, qartë për një përdorim me vend të mjetit, si në rastin kur demaskohen konceptet e shefit dhe të var-tësit, po ashtu edhe në rastin e skeçit të postjerit dhe linguis-tit. Gjithashtu, kalime të tilla montazhi si ajo e personazhit që nisët për të kërkuar malarikun, e alternuar herëpashere me t.r.e-nin real, i fuqizon mundësitë e shprehjes edhe nga ana ideomocionale, sepse i bën të qartë spektatorit se në vendin e dikurshëm të mushkonjave dhe kënetave janë bërë ndryshime të mëdha. Nuk harrojmë të përmendim këtu edhe imazhin e drejtë që krijohet për ta besuar më shumë udhëtimin e heroit, në kërkim të vazhdueshëm të pacientit në mungesë.

Interpretimi skenik i këngëve flet për një zgjerim të mundësive shprehëse të këngëve të futura në film.

Përgjithësisht, këndvështrimi i prerjes së planeve, mizanskena brenda kuadrit, ritmi kinematografik, në tërësi detyrat kompozicionale që shtronte lloji i filmit, janë zgjidhur drejt.

Filmi kinospetaktel «Kur hiqen maskat» do të kishte fituar shumë më tepër vlera emocionuese në qoftë se do të ishin patur parasysh disa kërkesa që burojnë si nga konceptimi i vetë filmit, edhe nga specifika e llojit të tillë kinematografik.

Përqëndrimi i materialit veçem në skeçe dhe këngë, duke patur parasysh trajtimin e filmit si variete, ka sjellë si pasojë krijimin e një farë monotonie në ndërtimin e spektaklit. Mungesa e përodive, intermexove, pantomimave, kupleteve, recimit satirik apo etydeve akrobatike e ka dobësuar plastikën emocionale, e ka kufizuar ndikimin pozitiv tek spektatori.

Kalimi nga njëri skeç tek tjetri dhe, përgjithësisht, njësimi i materialit filmik vetëm me anën e aktorit Skënder Sallaku është i pamjaftueshëm. Këtu do të ndihmonte materiali ilustrativ pozitiv që lidhet me interpretimin e aktorit tjetër Skënder Plasari, po të që futur organikisht në film, por në mënyrën që është dhënë, ai nuk ka arritur të shkrijë në një të vetme mohimin dhe pohimin, të renë dhe të vjetërën. Gjithashtu, që filmi të kishte një rritje emocionale, materiali duhet të ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që të vinte duke u rritur forca shprehëse e konfliktit apo e batutës humoristike, sepse ndihet një lloj rënijeje dhe zbehjeje e ecurisë së aksionit veçanërisht nga fundi, i cili nuk krijon efektin e dëshiruar tek spektatori. Ndonjë dobësi e dramaturgjisë së materialit skenik mund të ishte shmangur nga autorët e filmit e sidomos nga skenaristi, siç është rasti i Robertinos, ku nuk është e nevojshme që, për të dhënë idenë se konceptet e tij janë të gabuara, të dehej me raki, sepse edhe pa alkoolin ai nuk është rreth pak i dëmshëm.

Duke parë filmin kinospetaktel «Kur hiqen maskat» të lindin disa mendime që kanë të bëjnë me zhvillimin më tej të këtij lloji kinematografik.

Fakti që spektatori ishte njohur edhe më parë me skeçet e filmit; nëpërmjet skenës apo ekranit të televizorit, shtron pyetjen: a duhet ekranizuar materiali i njohur skenik apo duhet krijuar material i ri letrar për kinospetaktel tonë të ardhshme? Një përgjigje e prerë për këtë nuk mund të jipet, por kjo gjë ka anën e vet pozitive, sepse materiali i njohur skenik ka kaluar provën e suksesit dhe shërben jo vetëm si një pikëmbështetje e sigurtë për regjisorin e filmit, por, nga ana tjetër, na lejon që fondin e estradave tona ta fiksojmë në celuloid për të mos e lënë të vdesë, të harrohet krijimtaria më e mirë e kësaj gjinie.

Por në kinospetaktel të kësaj natyre duhet bërë një zgjedhje më e kujdesshme e materialit që e ka kaluar provën e qëndrimit në skenë, duke zgjedhur ato skeçe apo pjesë që e ruajnë më shumë forcën e përgjithësimin artistik.

Ekziston mendimi se ekрани, duke i patur mundësitë shprehëse të mëdha, nuk duhet mbyllur në kuintat e skenës. Por kinemaja nuk ekziston vetëm për të dhënë kohën dhe hapësirën në pambarim dhe të pakufizuar, mundësi që skena nuk i ka. Kryesorja qëndron në faktin se edhe brenda kohës dhe hapësirës së kufizuar, me anën e gjuhës së filmit, krijon përsëri vlera të vërteta kinematografike, duke dhënë tablo të vërteta të realitetit. Pa kaluar në ekstrem, studiimi në të ardhshmen i këtyre mundësive, do të çelte perspektiva të reja në kthimin e materialit skenik në vlerë të vërteta filmike, duke ruajtur gjithmonë në sytë e spektatorit vërtetësinë e dokumentacionit, të pikësynimit për të bërë të njohura ato, me anë të mundësive të mëdha shprehëse të ekranit, vlera të caktuara të skenës sonë.

Pavarësisht nga këto, kinospetakteli «Kur hiqen maskat» kontribuon në edukimin komunist të spektatorit.